

## **Thirrje për Trajnim për Inovacion Pedagogjik**

Në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë në mes të Republikës së Kosovës dhe shtetit të Izraelit, Ambasada e Izraelit në Kosovë ofron mundësinë e pjesëmarrjes së profesionistëve të fushës së arsimit nga Kosova në Trajnimin për Inovacionin Pedagogjik.

Trajnimi me mundësi për zhvillim profesional do të mbahet në periudhën 22 janar – 10 shkurt 2023, në Jeruzalem. Ky trajnim organizohet nga Mashav Center në Jeruzalem dhe synon zhvillimin profesional për :

- Drejtorët e Arsimit në MASHTI
- Drejtorët e Arsimit në Komuna (DKA)
- Drejtorët e shkollave të mesme dhe fillore
- Mësimdhënësit
- Ligjëruesit në fushën e pedagogjisë.

Të gjithë personat e lartcekur inkurajohen të aplikojnë duke plotësuar formularin e bashkangjitur të aplikimit dhe duke e dërguar në adresën elektronike [Tamar.Ziv@mfa.gov.il](mailto:Tamar.Ziv@mfa.gov.il) deri më 23.12.2022.

Shpenzimet e qëndrimit dhe trajnimit mbulohen nga organizatori, ndërkohë që udhëtimi mbulohet nga vetë aplikantët e suksesshëm ose nga institucioni ku punojnë.